



ZYRA E BANKES BOTERORE, Tiranë

Thirrje për Projekte në kuadrin e Programit të Granteve të Vogla

Programi i Granteve të Vogla mundëson Bankën Botërore të promovojë dialogun dhe shpërndarjen e informacionit tek organizatat jofitimprurëse për zhvillimin e forumeve jashtë fushës së aktivitetit të saj. Objektivi i Granteve të Vogla për vitin 2004 përqëndrohet në *fuqizimin e angazhimit qytetar të grupeve të mënjanuara dhe të rrezikuara të popullsisë për t'u përfaqësuar edhe ato në proceset e zhvillimit.*

Zyra e Bankës Botërore në Tiranë ju fton të paraqisni projekte që trajtojnë:

- Mundësimin e informacionit dhe lidhjeve të grupeve të rrezikuara të popullsisë me organizata/institucione të tjera;
- Ndërgjegjësimin e opinionit publik mbi nevojat e këtyre shtresave të mënjanuara;
- Permiresimin e transparencës publike dhe përgjegjshmerisë së qeverisë përmes fuqizimit të komuniteteve nepermjet ushtrimit të drejtës së informacionit dhe monitorimit të shërbimeve publike;
- Rritjen e kapacitetit të këtyre grupeve për të influencuar opinionin publik dhe për të negociuar me pushtetin qendror dhe atë vendor;
- Nxitjen e integritetit shoqëror të grupeve të përjashtuara dhe të rrezikuara;
- Nxitjen e proceseve pjesëmarrëse të këtyre grupeve në vendimmarrje;
- Rishikimin e kuadrit ligjor mbi angazhimin qytetar dhe fuqizimin e grupeve të mënjanuara. Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor të duhur mbi angazhimin qytetar.

Janë të ftuar të aplikojnë në këtë program organizata vendase të shoqërisë civile. Të interesuarit mund të paraqiten për të tërhequr format e aplikimit dhe informacione të tjera mbi kriteret e aplikimit pranë Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë. Ky informacion është vendosur edhe në faqen e internetit: www.worldbank.org.al.

Forma e aplikimit dhe dokumentat e tjera të nevojshme duhet të dorëzohen në një zarf pranë Zyrës së Bankës Botërore në adresë të Koordinatorit të Programit të Granteve të Vogla jo më vonë se 5 Shkurt 2004.

Adresa:

Koordinatori i Programit të Granteve të Vogla

Banka Botërore

Rruga “Dëshmoret e 4 shkurtit”, Nr. 34

Tel: 042 405 87/88/89

Fax: 042 405 90

Tiranë